

VENDIM
Nr. 15, datë 20.1.2021

**MBI DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT NR. 140, DATË 24.9.2019,
“MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘IRARBA ENERGJI’ SHPK NË VEPRIMTARINË
E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC ‘SHËNGJUN’, ME
KAPACITET TË INSTALUAR 2040 kw”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 113, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave ERE-s”, të ndryshuar, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 20.1.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 9/7 prot., datë 15.1.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 140, datë 24.9.2019, ‘Mbi licencimin e shoqërisë ‘Irarba Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Shëngjun’, me kapacitet të instaluar 2040 kw””,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 140, datë 24.9.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Irarba Energji’ sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali ‘Shëngjun’ me kapacitet të instaluar 2040 kw”, vendosi:

“1. Të licencojë shoqërinë “Irarba Energji” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shëngjun” me kapacitet të instaluar 2040 kw, për një afat 29 vjet e 1 muaj, me kusht që, të depozitojë në ERE përpara fillimit të veprimtarisë së prodhimit, lejen mjedisore me parametrat teknike të përditësuar, sipas ndryshimeve të Kontratës Shtesë të Koncesionit nr. 240 rep. dhe nr. 86 kol., datë 5.4.2016, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (Ndërtim-operim-transferim), për ndërtimin e HEC “Shëngjun”, të ndryshuar”.

2. Të depozitojë në ERE çdo dokument/leje që i nënshtrohet procedurës së rinovimit, nga institucionet që i lëshojnë ato, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të afatit të parashikuar në këto leje.

3. Mos plotësimi i kushteve të këtij vendimi përbën shkak për rishikimin e tij.”.

- Në zbatim të kësaj vendimmarrjeje, shoqëria duhet të përcillte në ERE, përpara fillimit të operimit, lejen mjedisore, të rinovuar, në zbatim të ndryshimeve që solli Kontrata Shtesë e Koncesionit nr. 240 rep. dhe nr. 86 kol., datë 5.4.2016.

- Në vijim të kësaj vendimmarrjeje dhe në kuadër të plotësimit të kushtit të vendosur në vendimin e licencimit nr. 140/2019, shoqëria “Irarba Energji”, ka përcjellë në ERE konfirmimin e lejes nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në të cilën përcaktohet se, bazuar në faktet e mëposhtme:

- Aktiviteti pas marrjes së lejeve/licencave përkatëse është pajisur me leje ndërtimi që është leja përfundimtare për zbatimin e një projekti;

- Punimet e zbatimit kanë filluar, bazuar në lejet/licencat përkatëse;

- Për nga pikëpamja mjedisore, nuk kemi shtrirje në zona të tjera, ndryshim kuote, prekje të sipërfaqeve, zgjerime etj.

Në bazë të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, ky projekt nuk duhet t’i nënshtrohet sërish procedurave të VNM-së.

- Sa më sipër, shoqëria “Irarba Energji” sh.p.k. ka plotësuar kushtin e vendosur në pikën 1, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 140, datë 24.9.2019, “Mbi licencimin e shoqërisë ‘Irarba Energji’

sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga HEC ‘Shëngjun’ me kapacitet të instaluar 2040 kw”.

- Me plotësimin e kushtit nga ana e shoqërisë, nuk ka më asnjë dokument që ka të dhëna se duhet t’i nënshtrohet procedurës së rinovimit. Kjo referuar edhe konstatimeve të vendimit përkatës të licencimit nr. 140/2019. Për rrjedhojë, aktualisht, shoqëria rezulton me një dokumentacion të plotësuar tërësisht.

- Në nenin 113, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të tërësishëm apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vet organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pika 1 e vendimit të Bordit të ERE-s nr. 140, datë 24.9.2019, ndryshon, si vijon:

Ishte:

1. Të licencojë shoqërinë “Irarba Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shëngjun” me kapacitet të instaluar 2040 kw, për një afat 29 vjet e 1 muaj, me kusht që, të depozitojë në ERE, përpara fillimit të veprimtarisë së prodhimit, lejen mjedisore me parametrat teknike të përditësuar, sipas ndryshimeve të Kontratës Shtesë të Koncesionit nr. 240 rep. dhe nr. 86 kol., datë 5.4.2016, “Për disa ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT (Ndërtim-operim-transferim), për ndërtimin e HEC ‘Shëngjun’, të ndryshuar”.

Bëhet:

1. Të licencojë shoqërinë “Irarba Energji” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “Shëngjun” me kapacitet të instaluar 2040 kw, për një afat 29 vjet e 1 muaj.

2. Pikat 2 dhe 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 140, datë 24.9.2019, shfuqizohen.

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti